



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 59, datë 10.09.2025

PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT PREJ 6.200.000 (GJASHTË MILION E DYQIND MIJË) LEKË PËR FURNIZIMIN ME ORENDI E PAJISJE TË SHKOLLËS SË MESME TË PËRGJITHSHME MANËZ, NJËSIA ADMINISTRATIVE MANËZ, SIPAS PROJEKTIT “FV ORENDI E PAJISJE GJIMNAZI MANËZ”

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr.115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, Ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.115, datë 24.12.2024 “Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2025 dhe Programin Buxhetor Afatmesëm 2025-2027” si dhe sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Arsimit, Kulturë, Rini, Sporte dhe Komunitete Fetare, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:



1. Miratimin e përdorimit të fondit prej 6.200.000 (gjashtë milion e dyqind mijë) lekë për furnizimin me orendi e pajisje të Shkollës së Mesme të Përgjithshme Manëz, Njësia Administrative Manëz, sipas projektit “FV orendi e pajisje Gjimnazi Manëz”.
2. Ky fond do të merret nga fondi rezervë i Bashkisë Durrës, miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.115, datë 24.12.2024 “Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2025 dhe Programin Buxhetor Afatmesëm 2025-2027.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria e Arsim, Kulturë, Rini, Sporte dhe Komunitete Fetare dhe Qendra Ekonomike e Arsimit, Bashkia Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

ZËVENDËSKRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK Durrës

Denisa Luarasi



U shpall sot me datë 11.09.2025





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës


Nr. 600 prot.

Durrës, më 11 .09 .2025

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS

KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.59 datë 10.09.2025 ,” Për miratimin e përdorimit të fondit prej 6.200.000 (gjashtë milion e dyqind mijë) lekë për furnizimin me orendi e pajisje të shkollës së mesme të përgjithshme Manëz, Njësia Administrative Manëz, sipas projektit “FV orendi e pajisje gjimnazi Manëz”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI
EMILJAN JANI

